



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Raport Konsultativ

Shqyrtimi i shtatë i tarifave të energjisë elektrike

SHTET7 (2013-2016)

Vlerësimi i përkohshëm – Vlerësim i detajuar i Gjenerimit të KEK-ut

Deklaratë

Ky dokument për konsultim është përgatitur nga ZRRE për qëllime të pranimit të ndonjë komenti eventual nga palët me interes. Ky dokument nuk përfaqëson vendimin e ZRRE-së.

8 janar 2012

Përmbajtja

| | | |
|----------|---|----------|
| 1 | Hyrje | 1 |
| 2 | Vlerësimi i Përkohshëm i Kostove të Supozuara të Furnizimit me Linjit..... | 2 |
| 2.1 | Propozimet e CAPEX të Divizionet të Minierave të KEK-ut | 2 |
| 2.2 | Vlerësimi i Përkohshëm i ZRRE-së i Propozimeve për Capex të Divizioneve të Minierave të KEK-ut..... | 3 |
| 2.2.1 | Ekskavator me rendimet të lartë..... | 3 |
| 2.2.2 | Pajisjet ndihmëse | 4 |
| 2.2.3 | Kostot e shpronësimit – Fshati Hade..... | 4 |
| 2.2.4 | Stacionet kthyese | 4 |
| 2.2.5 | Renovimi i Makinerisë së kombinuar A&B TC – B | 4 |
| 2.2.6 | Makineritë e rënda..... | 4 |
| 2.2.7 | Riparimi i dy ekskavatorëve..... | 4 |
| 2.2.8 | Shiritat dypalësh bartës për SJL..... | 5 |
| 2.2.9 | Kostot tjera kapitale | 5 |
| 2.2.10 | Vlerësimi i Përkohshëm i ZRRE-së për propozimet e Capex të Divizioneve të Minierave të KEK-ut 5 | |
| 2.3 | Propozimet e Opex të Divizionit të Minierave të KEK-ut | 6 |
| 2.4 | Vlerësimi i Përkohshëm i ZRRE-së i Propozimeve për Opex të Divizioneve të Minierës së KEK-ut | 6 |
| 2.4.1 | Rialokimi i kostove të administratës qendrore | 6 |
| 2.4.2 | Nivelet e stafit | 6 |
| 2.4.3 | Kostot për paga dhe ato relevante | 6 |
| 2.4.4 | Riparimet dhe mirëmbajtja | 7 |
| 2.4.5 | Energjia elektrike dhe shërbimet tjera komunale | 7 |
| 2.4.6 | Shpenzimet tjera operative | 8 |
| 2.4.7 | Transporti | 8 |
| 2.4.8 | Kostot e sigurisë | 8 |
| 2.4.9 | Vlerësimi i Përkohshëm i ZRRE-së për Propozimet e Opex të Divizionit të Minierës së KEK-ut..... | 8 |
| 2.4.10 | Kthimi i supozuar mbi kapitalin | 9 |

| | | |
|----------|--|-----------|
| 2.4.11 | Vlerësimi i Përkohshëm i ZRRE-së për kostot e supozuara të Linjtit | 9 |
| 3 | Vlerësimi i Përkohshëm i Gjenerimit të Rregulluar të KEK-ut | 10 |
| 3.1 | Capex i propozuar – Kosova A | 10 |
| 3.1.1 | Renovimi kapital Njësia A3 | 11 |
| 3.1.2 | Transporti Hidraulik i Hirit Kosova A | 11 |
| 3.1.3 | TCA - 2620 Njehësorve që punojnë në vazhdimësi (Running Meters) (duke i përfshirë 4 portat e rrethojës të ngritura lartë)..... | 11 |
| 3.1.4 | Kamerat e vëzhgimit..... | 12 |
| 3.1.5 | Makina e re e zjarr fikjes për Gjenerim | 12 |
| 3.1.6 | Renovimi kapital i Njësive A4 dhe A5 | 12 |
| 3.1.7 | Renovimi i Njësive A3, A4 | 12 |
| 3.1.8 | Renovimi i Njësive A3, A4, A5..... | 12 |
| 3.1.9 | Pompat e reja të kazanit me shpejtësi të ndryshueshme të furnizimit, Njësia A3, A4..... | 12 |
| 3.1.10 | Vlerësimi i Përkohshëm i ZRRE-së për Capex për Kosovën A | 13 |
| 3.2 | Opex i Propozuar i Kosovës A | 13 |
| 3.2.1 | Rialokimi i kostove të administratës qendrore | 13 |
| 3.2.2 | Kostot e staf-it | 13 |
| 3.2.3 | Energjia elektrike dhe shërbimet tjera komunale | 13 |
| 3.2.4 | Kostot e mirëmbajtjes | 14 |
| 3.2.5 | Kostot e Materialeve dhe Furnizimeve | 14 |
| 3.2.6 | Shpenzimet tjera operative | 14 |
| 3.2.7 | Vlerësimi i Përkohshëm i ZRRE-së të Propozimeve të Opex për Kosovën A të KEK-ut..... | 15 |
| 3.3 | Kosova B – Capex i propozuar | 15 |
| 3.3.1 | TCB - 2550 rrethoja (duke i përfshirë 4 portat me rrethojë të ngritur lartë) | 16 |
| 3.3.2 | Kamerat e vëzhgimit..... | 16 |
| 3.3.3 | Makinë e re e zjarr fikjes për gjenerim..... | 17 |
| 3.3.4 | Hapja e cilindrave me presion të lartë dhe të tjera | 17 |
| 3.3.5 | Kornizë e re e jashtme për turbinën me presion të lartë, Njësia B1 | 17 |
| 3.3.6 | Renovimi kapital, Njësia B1 | 17 |
| 3.3.7 | Vlerësimi i përkohshëm i ZRRE-së i Capex për Kosovën B..... | 17 |
| 3.4 | Kosova B Opex i Propozuar | 18 |

| | | |
|----------|--|-----------|
| 3.4.1 | Rialokimi i kostove të administratës qendrore | 18 |
| 3.4.2 | Kostot e stafit | 18 |
| 3.4.3 | Energjia elektrike dhe shërbimet tjera komunale | 18 |
| 3.4.4 | Kostot e mirëmbajtjes | 18 |
| 3.4.5 | Shpenzimet tjera operative | 19 |
| 3.4.6 | Vlerësimi i Përkohshëm i ZRRE-së i propozimeve Opex të Kosovës B të KEK-ut | 19 |
| 4 | Parametrat tjerë rregullatorë..... | 20 |
| 4.1 | Faktorët e efikasitetit | 20 |
| 4.2 | WACC..... | 20 |
| 5 | MAR i përkohshëm 2013-2016 | 21 |

1 Hyrje

Në letrën e datës 8 qershor 2012, ZRRE shpalli fillimin e Shqyrtimit të Tarifës për Energjinë elektrike 7 (SHTE7) e cila, për herë të parë, do të mundësoi caktimin e të hyrave të lejuara maksimale të të licencuarit gjatë periudhave shumë vjeçare. Ato të hyra maksimale të lejueshme sipas ligjit duhet të jenë adekuate për të mbuluar kostot e arsyeshme operative dhe kapitale për kryerjen e aktiviteteve të licencuara. Në mënyrë që të përcaktohet përshtatshmëria e të hyrave, ZRRE duhet me kujdes të vlerësoj kostot e parashikuara të të licencuarit dhe duhet të ketë rezultate të kënaqshme se propozimet e tyre janë të arsyeshme dhe të përshtatshme. Duhet vënë re se, sipas ligjit, të licencuarit janë të obliguar të ofrojnë të gjitha të dhënat që i kërkon ZRRE për këtë analizë. Nga KEK-u është kërkuar që t'i paraqet aplikacionin e tyre ZRRE-së dhe publikut më 3 shtator. Që nga ajo datë, ZRRE ka punuar ngushtë me kompaninë që të qartësojë aplikimet fillestare. KEK-u që nga atëherë ka dërguar të dhëna dhe arsyetime shtesë substanciale.

Në harmoni me Rregullat e saja të publikuara të Çmimit, ZRRE duhet t'i caktoj dhe të konsultohet për propozimet e saja për të Hyrat Maksimale të Lejuara (HML) që duhet të kthehen nga i licencuari gjatë periudhës rregullatore, dhe arsyetimin për këto. Rregullat lejojnë që ZRRE të ndryshoj, largoj apo zëvendësoj secilën pjesë të propozimeve të të licencuarit aty ku një veprim i tillë është i arsyeshëm. ZRRE duhet të caktoj HML për secilën biznes të Gjenerimit, Operator të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) dhe Furnizimit Publik me Energji Elektrike. Pasi që Qeveria ka nënshkruar marrëveshje me investuesin e sektorit privat për shitjen e biznesit të Shpërndarjes dhe Furnizimit të Energjisë Elektrike të Kosovës, ZRRE ka zgjedhur të prezantoj Vlerësimin e saj të Përkohshëm për gjenerim ndarazi nga ai i shpërndarjes dhe furnizimit.

Gjithashtu është e rëndësishme të vihet re, ndonëse ZRRE nuk rregullon Divizionin e Minierave të KEK-ut, ajo duhet të caktoj një vlerë në koston e thëngjillit, e cila përbën një pjesë të koston së gjenerimit të energjisë elektrike. Në të ardhmen, mund të jetë se çmimi i thëngjillit do të caktohet nga një marrëveshje e furnizimit me linjit, por aktualisht asnjë marrëveshje e tillë nuk është në fuqi. Në mënyrë që të rishikohet çmimi ekzistues i thëngjillit që ngarkohet në mes të divizioneve të minierave dhe gjenerimit të KEK-ut, ZRRE ka kërkuar nga inxhinierët konsulent EIHP që të ekzaminojnë koston e prodhimit të thëngjillit nga divizioni i minierave, si dhe koston e gjenerimit. ZRRE e ka marrë raportin e tyre parasysh në Vlerësimin e Përkohshëm.

Ky dokument përbën pjesë të Vlerësimit të Përkohshëm dhe duhet të lexohet së bashku me "Vlerësimin e Përkohshëm – Pasqyrë e përgjithshme" që është publikuar njëkohësisht më këtë dokument dhe anekset e tij. Ai është i strukturuar si në vijim:

Pjesa 2 – Vlerësimi i Përkohshëm i Kostove të Supozuara të Furnizimit me Linjit.

Pjesa 3 – Vlerësimi i Përkohshëm i Gjenerimit të Rregulluar të KEK-ut

Pjesa 4 – Parametrat tjerë rregullatorë

Pjesa 5 – MAR i Përkohshëm 2013-2016

2 Vlerësimi i Përkohshëm i Kostove të Supozuara të Furnizimit me Linjit

Rregulla e Çmimit të Gjenerimit të ZRRE-së pohon se në mungesë të një marrëveshjeje të furnizimit me linjit, ZRRE duhet të caktoj një kosto të supozuar të furnizimit me linjit për t'i rikthyer kostot për gjeneratorët e rregulluar, Kosova A dhe Kosova B. Rregulli tutje thotë se kostot e supozuara të furnizimit me linjit “do të llogariten në të njëjtën mënyre si edhe kostot tjera të arsyeshme të Gjeneratorit të Rregulluar, që përbën një zhvlerësim të supozuar, rikthimin e supozuar në kapital, dhe kostot e supozuara të arsyeshme operative dhe të mirëmbajtjes.” Në këtë pjesë, ZRRE komenton për vlerësimin e saj të kostove të cekura operative dhe kapitale të biznesit të minierave të KEK-ut.

2.1 Propozimet e CAPEX të Divizionit të Minierës së KEK-ut

Më 19 tetor të vitit 2012, ZRRE lëshoi një dokument konsultativ (“Konsultimi i tetorit”) duke përcaktuar kuptueshmërinë e aplikacionit të KEK-ut deri më atë datë dhe duke kërkuar sqarime dhe arsytetime shtesë. Në veçanti, ZRRE i kërkoi KEK-ut që të shpjegoj dhe arsyetoj projektet kapitale të përshkruara në parashtresën e tij të gushtit. Projektet kapitale të planifikuara gjatë periudhës janë të përshkruara në Aneksin A, së bashku me një vlerësim teknik të arsytimit të KEK-ut për projektet.

Përveç projekteve të planifikuara për periudhën vijuese të kontrollit 2013-2016, aplikacioni i KEK-ut përmbante një numër të projekteve për vitin 2012. Gjatë shqyrtimit të SHTE6, KEK-u kishte kërkuar një shumë shtesë prej €28 milion të cilat janë lejuar në tërësi nga ZRRE. Këto projekte të vitit 2012 janë dhënë të specifikuara në tabelën e më poshtme:

Tabela a – Projektet kapitale në rrugë e sipër të Divizionit të Minierave 2012

| Projektet kapitale të propozuara të KEK-ut për Divizionin e Minierave | 2012 €000s | 2013 €000s | 2014 €000s | 2015 €000s | 2016 €000s | Total €000s |
|---|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|----------------|
| Projektet e zbatuara që nga viti 2012 | | | | | | |
| Bartja e kontratave të vitit 2011 nga huat | | | | | | |
| Ekskavator me rendiment të lartë* | | | | | | |
| Pajisjet ndihmëse* | | | | | | |
| Kostot e shpronësimit – Fshati Hade* | | | | | | |
| Totali i projekteve kapitale të kryera gjatë vitit 2012 | 28,000 | | | | | |

KEK-u tani ka ofruar informata për t'i arsyetuar këto si projekte të nevojshme. Megjithatë, duhet vënë re se tre projektet e shënuara me “*” në tabelën a sipër mund të konfirmohen se kërkojnë hulumtim të mëtutjeshme para se ato të përfshihen në kalkulimin e MAR-it 2013 – 2016. Përkohësisht, ZRRE i ka përfshirë këto kosto në kalkulimin e MAR, por do t'i kërkoj KEK-ut të ofroj dëshmi se nuk ka llogaritje të dyfishtë në mes të lejimit për investime kapitale në SHTE6 dhe këtyre të realizuara. Gjithashtu thekson se këto shpenzime është dashur të ishin planifikuar në mënyrën e duhur dhe se nevoja dhe kostoja e tyre të arsyetoheshin në SHTE6.

Tabela b poshtë i tregon projektet kapitale të planifikuara në Divizionin e Minierave të KEK-ut për periudhën e kontrollit të ri, 2013-2016:

Tabela b – Projektet e Propozuara Kapitale të Divizionit të Minierave 2013-2016

| Projektet për vitin 2013-2016 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | Total | |
|--|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|----------------|
| | €000s | €000s | €000s | €000s | €000s | |
| Stacionet kthyese | | | | | | |
| Renovimi i makinerisë së kombinuar A&B | | | | | | |
| Makineritë e rënda | | | | | | |
| Riparimi i dy ekskavatorëve / 2 ekskavatorëve kompakt | | | | | | |
| Ndërtesa e ndërrimet të rrobave | | | | | | |
| Shiritat dypalësh bartës | | | | | | |
| Sistemi i largët | | | | | | |
| Totali i projekteve të shpenzimeve kapitale 2013-2016 | | 15,827 | 63,500 | 62,000 | 19,000 | 160,327 |
| Shpenzimet totale kapitale (të gjitha vitet) | 28,000 | 15,827 | 63,500 | 62,000 | 19,000 | 188,327 |

2.2 Vlerësimi i Përkohshëm i ZRRE-së i Propozimeve për Capex të Divizionit të Minierës së KEK-ut

Tabela 7 e raportit të EIHP në Aneksin 1 i tregon projektet kapitale të propozuara nga Divizioni i Minierave të KEK-ut. EIHP i ka ekzaminuar nivelet e propozuara të shpenzimeve kapitale dhe ka rekomanduar ca reduktime në kosto për t'u lejuar nga ZRRE. Vlerësimet e ZRRE-së për të gjithë shpenzimet e paraqitura janë si në vijim.

2.2.1 Ekskavator me rendiment të lartë

KEK-u ka këshilluar që kërkohej riparim kapital i ekskavatorëve me rendimet të lartë. Kjo është planifikuar në mënyrë origjinale për vitin 2012, por se kjo është shtyrë deri në vitin 2013, që është sinkronizuar me riparimin kapital të Kosovës B. Buxheti origjinal ishte i planifikuar për këto investime ka qenë me i lartë, mirëpo, KEK-u tani ka

pranuar oferta nga kompanitë në vlerë më të ulët prandaj ZRRE e ka korrigjuar këto kosto për €0.7 milion.

2.2.2 Pajisjet ndihmëse

KEK-u ka prokuruar një sërë artikujsh kapital nën këtë titull për të modernizuar stokun e tij me pajisje ndihmëse, duke përfshirë, buldozerë, kamionë, kamionë vetë shkarkues, ekskavatorë, ngarkues, autovinça, minibus dhe Land Roverë. Ky investim prej €3 milion tashmë është bërë dhe pajisjet përkatëse janë vënë në shërbim.

2.2.3 Kostot e shpronësimit – Fshati Hade

Zhvendosja e banorëve të fshatit Hade kërkohet që të lejoj zgjerimin e nevojshëm të minierës. Kostot e risistemimit janë vlerësuar në €8 milion, një kosto që është jashtë kontrollit të KEK-ut, dhe bazohet në një dokument të cilën e ka paraqitur Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

2.2.4 Stacionet kthyese

Këto janë stacione kthyese që duhet të ngritën në shiritin bartës të thëngjillit në jug perëndim të Sibovcit dhe ZRRE pajtohet me këtë investim pasi që kjo është e arsyeshme.

2.2.5 Renovimi i Makinerisë së kombinuar A&B TC – B

KEK-u ka pohuar se është e nevojshme që të riparohen këto makineri për të siguruar furnizimin me thëngjill për stacionin e Kosovës B. KEK-u ka parashtruar të dhëna të pamjaftueshme për të arsyetuar këtë kosto. Për qëllime të Vlerësimit të Përkohshëm, ZRRE e ka përfshirë këtë investim kapitalë. Megjithatë, nëse nuk pranohen informata substanciale për të shpjeguar kërkesën për këto riparime dhe për të arsyetuar këtë kosto, ZRRE mund të refuzoj këtë shumë në Vlerësimin e tij Final.

2.2.6 Makineritë e rënda

KEK-u ka propozuar që t'i zëvendësoj makineritë e rënda dhe pajisjet. Edhe në këtë rast, KEK-u ka parashtruar hollësi të pamjaftueshme për të arsyetuar këtë kosto. Për qëllime të Vlerësimit të Përkohshëm, ZRRE e ka përfshirë këtë lejim. Megjithatë, nëse nuk pranohen informata substanciale për të shpjeguar kërkesën për këtë njësi dhe për të arsyetuar këtë kosto, ZRRE mund të refuzoj këtë shumë në Vlerësimin e tij Final.

2.2.7 Riparimi i dy ekskavatorëve

KEK-uthekson se dy ekskavatorët e ri kompakt dhe shiritat bartës vetëlëvizës kërkohen për minierën e Sibovcit për të siguruar një furnizim të vazhdueshëm me thëngjill për stacionet e Kosovës A dhe B. Buxheti i planifikuar për riparimin e këtyre dy ekskavatorëve në parastresën e parë nga KEK-u ka qënë shumë më i lartë se sa

ofertat aktuale. Megjithatë, KEK-u ka këshilluar ZRRE-në dhe konsulentët e saj se ofertat aktuale të pranuar nga KEK-u janë diku €15 milion nën shumën e vlerësuar që është kërkuar në mënyrën origjinale nga Kompania. Prandaj, ZRRE ka propozuar që të lejoj blerjen kapitale në përputhje me ofertat e pranuar.

2.2.8 *Shiritat dypalësh bartës për SJL*

KEK-uthekson se dy shirat e ri dypalësh bartës kërkohen për minierën e Sibovcit për të siguruar një furnizim të vazhdueshëm me thëngjill për stacionet e Kosovës A dhe B. KEK-u ka parashtruar hollësi të pamjaftueshme për të arsyetuar këtë kosto. Për qëllime të Vlerësimit të Përkohshëm, ZRRE e ka përfshirë këtë lejim kapital. Megjithatë, nëse nuk pranohen informata substanciale për të shpjeguar kërkesën për këtë investim dhe për të arsyetuar këtë kosto, ZRRE mund të refuzoj këtë shumë në Vlerësimin e tij Final.

2.2.9 *Kostot tjera kapitale*

KEK-u ka planifikuar tri projekte tjera kapitale për periudhën e re të kontrollit: një ndërtesë të re për ndërrimin e rrobave dhe një sistem kontrolli nga largësia. ZRRE konsideron se këto dy investime kapitale janë arsyetuar në mënyrë adekuate dhe se kostot janë të arsyeshme dhe janë propozuar për të lejuar këto investime kapitale në tërësi.

2.2.10 *Vlerësimi i Përkohshëm i ZRRE-së për propozimet e Capex të Divizionit të Minierës të KEK-ut*

Vlerësimi i përkohshëm i ZRRE-së i kostove kapitale të minierave të cilët do të përbëjnë pjesë të kostos së supozuar të furnizimit me linjit, që do të financohet nga gjenerimi i MAR, janë dhënë në tabelën c më poshtë.

Tabela c – Shpenzimet kapitale të divizionit të minierave

| Vlerësimi i Përkohshëm i ZRRE-së i i kërkesave të shpenzimeve kapitale të Divizionit të Minierës së KEK-ut (duke i përjashtuar grantet) | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | Total |
|---|---------|---------|---------|---------|---------|---------|
| | € 000's | € 000's | € 000's | € 000's | € 000's | € 000's |
| Capex i Propozuar i KEK-ut | 28,000 | 15,827 | 63,500 | 62,000 | 19,000 | 188,327 |
| Vlerësimi i Përkohshëm i ZRRE-së | 27,300 | 15,827 | 57,500 | 53,000 | 19,000 | 172,627 |
| Diferenca (€ 000's) | -700 | 0 | -6,000 | -9,000 | 0 | -15,700 |
| Diferenca (%) | -3% | 0% | -9% | -15% | 0% | -8% |

2.3 Propozimet e Opex të Divizionit të Minierave të KEK-ut

Në parashtrësen e tij, KEK-u i ka parashtruar kostot operative të saja të propozuara të administratës qendrore, të cilat ZRRE do t'i alokojë në bizneset e licencuara.

Disa nga këto kosto të parashtruara nuk janë të kontrollueshme, siç janë taksat. Të tjerat janë të kontrollueshme. ZRRE i ka rishikuar parashikimet e kostove të kontrollueshme të KEK-ut me mbështetjen e inxhinierëve konsulentë. Në rast të kostove si në vijim, ZRRE-së nuk i duket se nivelet e parashikimeve të kostove të KEK-ut janë arsyetuar plotësisht.

2.4 Vlerësimi i Përkohshëm i ZRRE-së i Propozimeve për Opex të Divizionit të Minierës së KEK-ut

2.4.1 Rialokimi i kostove të administratës qendrore

Në parashtrësën e tij, KEK-u i ka paraqitur kostot e saja operative nën një numër titujsh: kostot për paga, energjisë elektrike dhe shërbimet tjera komunale, mirëmbajtja, materialet dhe furnizimet, dispozitat për çështjet mjedisore, shpenzimet tjera operative dhe shpenzimet e brendshme. Ajo i alokoi këto kosto jo vetëm te aktivitetet e licencuara por gjithashtu edhe te Administrata qendrore e KEK-ut. Megjithatë, në termet rregullatorë, të gjitha këto kosto duhet t'i alokohen aktiviteteve të licencuara në mënyrë që ato të mbulohen përmes MAR-it adekuat. Prandaj, ZRRE i ka korigjuar kostot e paraqitura. Gjatë kryerjes së korigjimit, ZRRE e ka shfrytëzuar përpjesëtimin e kostove të KEK-ut për vitin 2012, dhe i ka aplikuar këto në mënyrë relevante. Vlerësimi më poshtë është sipas kostove të korigjuara.

2.4.2 Nivelet e stafit

KEK-u ka pohuar se numri i stafit në minierë do të zvogëlohet nga 3,177 në vitin 2012 në 2,891 gjer në fund të vitit 2017. Kjo në masë të madhe ka rrjedhë nga pensionimet.

ZRRE është e mendimit se këto nivele të stafit mund të jenë në gjendje që të zvogëlohen më tutje dhe se ky divizion duhet të jetë në gjendje që të përmirësoj prodhimin e vet. Në caktimin e Faktorit të Efikasitetit për Gjenerimin e KEK-ut, ZRRE ka për synim që të stimuloj kompaninë për të kërkuar përmirësime në prodhimtari.

2.4.3 Kostot për paga dhe ato relevante

KEK-u ka propozuar një ngritje vjetore prej 5% në paga në terma real për tërë kompanin mbi inflacionin. ZRRE nuk sheh ndonjë arsyetim për ngritje të tilla në terma real, në veçanti në nivele të ultë të prodhimtarisë që është dëshmuar nga KEK-u. I takon menaxhmentit të KEK-ut t'i caktoj nivelet e pagave, por duhet të gjej kursime gjetkë në biznes, pa prekur performancën. Prandaj, ZRRE propozon që kostot e

pagave për divizionin e minierës së KEK-ut të mbesin në nivele të vitit 2012 në caktimin e kostos së supozuar të linjtit.

2.4.4 Riparimet dhe mirëmbajtja

Kostot historike të riparimeve dhe të mirëmbajtjes së KEK-ut nuk kanë treguar ndonjë mostër të rregullt, dhe nivelet e parashikimit të mirëmbajtjes dhe riparimit janë poashtu të ndryshueshëm. KEK-u nuk ka ofruar ndonjë arsytim të qartë për shumën e parashikuar. Në bazë të kësaj paqartësie, ZRRE ka propozuar të caktoj parashikimin e lejimit kapital të mirëmbajtjes në nivel të kostove mesatare prej €1033 / 000t të thëngjillit.

2.4.5 Energjia elektrike dhe shërbimet tjera komunale

Sa i përket kostove të energjisë elektrike dhe shërbimeve tjera komunale, KEK-u ka raportuar kosto në dy kategori: derivate, gaz, dhe kosto të ujit. Këto kosto janë shtesë për aktivitetet e minierës, dhe se shumat vjetore të shkaktuara mund të priten se do të ndryshojnë me shumën e thëngjillit të nxjerrë. Megjithatë, kostoja e artikullit për këto shërbime e shprehur në 000t të thëngjillit pritet se do të mbetet konstante gjatë viteve.

Parashtesa e KEK-ut sa i përket derivateve ka treguar rritje të kostove të cilat Kompania i ka shpjeguar se kanë rezultuar nga ngritja e kostos së njësis së derivateve, duke parashikuar një ngritje prej 12% nga €321/000t të thëngjillit në vitin 2012 në €363/000t të thëngjillit në vitin 2013, dhe pastaj do të ngritet me shkallë ndryshuese në kostot e njësis deri në vitin 2016. KEK-u nuk ka ofruar ndonjë argument të qartë për të mbështetur këtë ngritje në kosto të njësis të derivateve në vitin 2013, e as të mbështes mostrën e ndryshueshme të ardhshme në lëvizjet e çmimit të derivateve. Prandaj, ZRRE e ka mbajtur vlerën e vitit 2012 prej €321/000t të thëngjillit për periudhën kontrolluese, duke pranuar se, si edhe me kostot tjera, këto do të korrigjohen gjatë tërë periudhës kontrolluese për të marrë parasysh inflacionin aktual. Kjo zvogëlon parashikimet e kostove të derivateve të KEK-ut në €2.4 milion për periudhën 2013-16 .

Kostot e propozuara të gazit dhe ujit të KEK-ut parashikohen të jenë diku €24.10/000t të thëngjillit në vitin 2013-16 gjatë periudhës së ardhme rregullatorë e cila është pak më e lartë se kostot e raportuara të kaluara të njësis, ndonëse vlerat e kaluara të raportuara kanë treguar variacione të papritura. ZRRE pret që kostot e njësisë do të mbesin mjaft stabile, ndërsa kostoja do të ndryshoj me sasinë e thëngjillit të prodhuar. ZRRE ka supozuar një vlerë prej €24/000t të thëngjillit e cila është një vlerë mesatare për periudhën 2008-2011. Rezultati është një korrigjim i vogël në rënie të kostove të aprovuara të gazit dhe ujit prej €34000 për periudhën 2013-2016.

2.4.6 Shpenzimet tjera operative

Në “shpenzime tjera operative”, KEK-u ka parashikuar kosto totale prej €139,775 milion në periudhën 2013-2016. Nga kjo shumë, €103,152 apo 74% paraqet tantiemen e pakontrollueshme të linjtit, e cila duhet ti paguhet Qeverisë nga KEK-u, 26% përqindëshi i mbetur përbën transportin e personelit në dhe brenda minierës, sigurinë, rialokimin e kostove të administrates qendrore, licencat dhe të “tjera”. Kategoria “të tjera” është arsyetuar se paraqet koston e lubrifikuesve, naftës, benzinës, kemikaleve dhe gazit, të cilat përbëjnë një kosto të konsiderueshme €10,424,000 gjatë periudhës 2013 deri në 2016.

2.4.7 Transporti

KEK-u ka paraparë kosto të qëndrueshme në ngritje të shërbimeve të transportit, e cila përfaqëson koston e bartjes së personelit brenda në kuadër të minierës, si dhe duke i transportuar ata në dhe nga vetë miniera. Parashikimi i KEK-ut paraqet një ngritje të vërtetë në shërbimet e transportit prej diku 22% gjatë periudhës në mes të vitit 2013 dhe 2016 në kohën kur numri i stafit do të zvogëlohet. KEK-u nuk ka ofruar ndonjë arsyetim për këtë ngritje, dhe ZRRE konkludon se do të ishte më e përshtatshme të mos ketë ngritje nga vlera e €115,000 që është parashtruar për vitin 2013.

2.4.8 Kostot e sigurisë

KEK-u ka parashikuar kosto vjetore të sigurisë në vlerën e njëjtë me vitin e kalua. Duke marrë parasysh shtrirjen e minierave, ZRRE nuk e sheh këtë shumë të paarsyeshme dhe propozon që kjo të lejohet plotësisht si pjesë e koston së supozuar për furnizim me linjit.

2.4.9 Vlerësimi i Përkohshëm i ZRRE-së për Propozimet e Opex të Divizionit të Minierës së KEK-ut

Tabela më poshtë i përmbledh shpenzimet operative totale të minierës të propozuara nga KEK-u për periudhën 2013 deri 2016, së bashku me vlerësimin e propozuar të ZRRE-së të atyre shpenzimeve të njëjta për qëllime të kalkulimit të kostove të supozuara të furnizimit me linjit për gjenerimin e rregulluar. Duhet vënë re se në tabelen poshtë nuk përfshinë efikasitetin e pritur dhe Tantiemen e Linjtit e cila është kosto kryesore dhe e pakontrollueshme për të dhënë një pasqyrë më të vërtetë të opex –it të Minierës.

Tabela d – Shpenzimet Operative të Divizionit të Minerës

| Vlerësimi i Përkohshëm i ZRRE-së i shpenzimeve operative të Divizionit të Minerës të KEK-ut | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | Total 2013-2016 |
|---|---------|---------|---------|---------|-----------------|
| | € 000's | € 000's | € 000's | € 000's | € 000's |
| Opex i propozuar i KEK-ut | 46,115 | 47,540 | 48,653 | 49,237 | 191,545 |
| Vlerësimi i Përkohshëm i ZRRE-së | 42,221 | 41,992 | 41,460 | 41,040 | 167,714 |
| Diferenca (€ 000) | -3,894 | -5,548 | -7,193 | -8,197 | -23,831 |
| Diferenca (%) | -8% | -12% | -15% | -17% | -12% |

2.4.10 Kthimi i supozuar mbi kapitalin

ZRRE, duke kalkuluar kostot e supozuara të furnizimit me linjit që duhet të lejohen si pjesë e Gjenerimit MAR, duhet të bëj një supozim rreth kthimit adekuat në kapital për Divizionin e minerës.

ZRRE ka supozuar Mesataren e Ponderuar të Kostos së Kapitalit (WACC) për Divizionin e Minerave duke u bazuar në vlerësimet paraprake të kërkeses për Kthim të ekuitetit, kostove aktuale të financimit të borxhit dhe nivelit aktual të gearing-ut (duke përfshirë restriksionet e paraqitura në lidhje me gearing-un në diskutimet e mëhershme të ZRRE-së lidhur me WACC)

Fillimisht ZRRE ka supozuar se të gjitha kompanitë e rregulluara kërkojnë kthim komercial në ekuitet. Më tutje ZRRE ka kërkuar nga Qeveria udhëzime lidhur me nivelin e kthimit në ekuitet që qeveria do të kërkonte si pronare e vetme e kompanive publike. Qeveria është shprehur se do të konsiderojnë kthim më të ulët në ekuitet nga operatorët në pronësi publike krahasuar me kthimin që do të mund të kërkohej nga një operator privat. Vlerësimi fillestar i ZRRE-së është se niveli i kthimit në ekuitet prej 8.0% (pas taksës) do të ishte i duhur për kompani në pronësi publike. ZRRE ka përdorur këtë kthim në ekuitet për të vlerësuar WACC-un e divizionit të Gjenerimit.

WACC-u rezultues për Divizionin e Minerës është 5.50% (real, para tatimit)

2.4.11 Vlerësimi i Përkohshëm i ZRRE-së për kostot e supozuara të Linjtit

Kostot e supozuara të linjtit janë përmbledhur në tabelën në vijim:

| Vlerësimi fillestar i MAR-it të Divizionit të Minerave | 2013 (€m) | 2014 (€m) | 2015 (€m) | 2016 (€m) | Gjithsej (€m) |
|--|--------------|--------------|--------------|--------------|------------------|
| Minierat | 89.3 | 89.9 | 92.0 | 92.6 | 363.8 |

3 Vlerësimi i Përkohshëm i Gjenerimit të Rregulluar të KEK-ut

3.1 Capex i propozuar – Kosova A

Projektet kapitale të planifikuara për Kosovën A gjatë periudhës rregullatore janë të përshkruara në Aneksin A, së bashku me një vlerësim teknik të arsytimit të KEK-ut për projektet.

Përveç projekteve të planifikuara për periudhën e ardhme kontrolluese, 2013 – 2016, parashtrëna e KEK-ut përmbante një numër projektesh për vitin 2012. KEK-u tani ka ofruar informata për t'i arsytuar këto si projekte të nevojshme, ndonëse ZRRE vëren se këto kosto duhej të arsyttoheshin si pjesë e procesit të SHTE6. ZRRE-së do t'i duhen informata shtesë nga KEK-u që të bindet se nuk ka kalkulim të dyfishtë në mes të lejitimit kapitale të SHTE6 dhe këtyre propozimeve për MAR 2013-2016. Tash për tash, ZRRE i ka përfshirë këto në kalkulimin e ri të MAR. Këto projekte të vitit 2012 për Kosovën A janë të dhëna në artikuj në tabelën e më poshtë.

Tabela e – Projektet Kapitale Në vazhdim Kosova A

| Projektet kapitale të propozuara të KEK-ut për Gjenerim Kosova A | 2012 €000s | 2013 €000s | 2014 €000s | 2015 €000s | 2016 €000s | Total €000s |
|--|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|----------------|
| Projektet e vazhduara nga viti 2012 | | | | | | |
| Renovim kapital Njësia A3 | | | | | | |
| Transportues Hidraulik i dheut | | | | | | |
| Pastrues ajri elektrostatik Njësia A5 | | | | | | |
| Pastrues ajri elektrostatik Njësia A3 | | | | | | |
| Transformatori Njësia A3 | | | | | | |
| Pajisjet e monitorimit të mjedisit | | | | | | |
| Kompresorët e ajrit njësitë A | | | | | | |
| Projektet kapitale totale të vitit 2012 të vazhduara | 40,417 | | | | | |

Përveç kësaj, tabela f më poshtë i tregon projektet kapitale për Kosovën A të planifikuara nga Divizioni i Gjenerimit i KEK-ut për periudhën e re kontrolluese, 2013-2016:

Tabela f – Projektet Kapitale të Propozuara të Kosovës A 2013-2016

| Projektet për vitin 2013-2016 | 2012 €000s | 2013 €000s | 2014 €000s | 2015 €000s | 2016 €000s | Total €000s |
|---|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|----------------|
| TCA-2620 Running meters & portat rrethojë të ngritura lartë | | | | | | |
| Kamerat e vëzhgimit | | | | | | |
| Makinë e re e zjarr fikjes | | | | | | |

| | | | | | | |
|--|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|----------------|
| Renovimi kapital i Njesisë A4 | | | | | | |
| Filtër të ri elektrostatik Njësia A4 | | | | | | |
| Kompresorët e ajrit - TCA | | | | | | |
| Pompa e furnizimit të kazanit Njësia A3 | | | | | | |
| Pompa e furnizimit të kazanit Njësia A4 | | | | | | |
| Instalimi i ftohësve të ujit Njësitë A3, A4, A5 | | | | | | |
| Renovimi kapital i Njesisë A5 | | | | | | |
| Renovimi Vjetor Njësitë A3 dhe A4 | | | | | | |
| Renovimi Vjetor Njësitë A3, A4, A5 | | | | | | |
| Renovimi Vjetor Njësitë A3, A4, A5 | | | | | | |
| Totali i shpenzimeve të projekteve kapitale 2013-2016 | | 22,861 | 19,530 | 12,750 | 10,000 | 65,141 |
| Shpenzimet kapitale totale (të gjitha vitet) | 40,417 | 22,861 | 19,530 | 12,750 | 10,000 | 105,558 |

3.1.1 Renovimi kapital Njësia A3

Renovimi kapital i Njesisë A3 i planifikuar për vitin 2012 fillimisht është vlerësuar shumë më ulët, mirëpo gjatë periudhës rishikuese, KEK-u i ka kontraktuar kompani të ndryshme për kryerjen e punëve të nevojshme, sipas shumave të paraqitura për secilin aktivitet të kontraktuar të dhënat tregojnë një rritje të konsiderueshme.

Sipas informatave të pranuar nga KEK-u, renovimi kapital do të kryhet deri në fund të vitit 2012. Punët përfshijnë riparime të turbinës së avullit, elektrogjeneratorit dhe kazanit.

3.1.2 Transporti Hidraulik i Hirit Kosova A

Sistemi i ri i transportit Hidraulik të Hirit për Kosovën A është i nevojshëm për të parandaluar praktikën e transportimit të hirit në shirit të hapur deri tek grumbulli i hirit që nuk është i mbuluar. Kjo do t'i kontribuojë në mënyrë të madhe zbutjes së problemeve të lirimit të pluhurit në komunitetet afër. Sistemi i ri do të lejojë që hiri të përzihet me ujë dhe të transportohet me gyp deri tek sektori i zbrazjes në minierë.

Projekti është planifikuar për vitin 2012. I njëjti projekt është kryer për Kosovën B dhe kostoja e investimit duket se është e arsyeshme.

3.1.3 TCA - 2620 Njehësorve që punojnë në vazhdimësi (Running Meters) (duke i përfshirë 4 portat e rrethojës të ngritura lartë)

KEK-u ka propozuar që të ngritet rrethoja e cila është e nevojshme për të ndarë dhe për të mbrojtur pronën e paluajtshme të Termocentralit Kosova A nga divizionet fqinje të thëngjillit. KEK-u ka ofruar hollësi të specifikimit dhe arsyetimit për këtë kosto. ZRRE e konsideron këtë të arsyeshme dhe propozon të lejojë këtë kosto plotësisht.

3.1.4 Kamerat e vëzhgimit

KEK-u ka propozuar që të instalohen kamerat e sigurisë që kanë për synim të monitorojnë objektin e Termocentralit të Kosovës A që instalohen në intervale prej 60 metra në rrethojën e re të sigurisë. ZRRE ikonsideron këto kosto të arsyeshme dhe propozon që të lejoj plotësisht.

3.1.5 Makina e re e zjarr fikjes për Gjenerim

KEK-u ka për synim që të blej një makinë të re të zjarrfikjes me shkallë prej 40 metra pasi që pajisjet ekzistuese nuk mund të arrijnë mjaft lartë. Në një kosto të tillë ZRRE e konsideron këtë të arsyeshme dhe propozon që të lejoj këto kosto plotësisht.

3.1.6 Renovimi kapital i Njesisë A4 dhe A5

KEK-u duhet të ndërmerr një renovim kapital të njesisë A4 në vitin 2013, dhe Njesisë A5 në vitin 2014, sepse janë arritur orët maksimale të operimit në këtë Njësi. KEK-u do t'i vazhdoj punët edhe në turbo gjenerator dhe në kazan si pjesë e pakos. EIHP ka rekomanduar që të mbaj KEK-un në vlerësimin origjinal.

ZRRE është e kënaqur që këto renovime kapitale do të shtojnë përfitime në sigurinë e rritur të pajisjeve dhe funksionalitetit, efikasitetit të ngritur dhe dispozicion të njesisë, si dhe siguri të ngritur për stafin dhe ZRRE propozon që të lejoj këto kosto për dy Njësitë A4 dhe Njesisë A5.

3.1.7 Renovimi i Njësive A3, A4

KEK-u planifikon që të zhvilloj riparime kapitale në Njësitë A3 dhe A4 në vitin 2014 gjatë ndërprerjes vjetore të njesisë në mënyrë që të mirëmbaj performancën dhe qëndrueshmërinë e saj operative.. ZRRE e konsideron këtë të arsyeshme dhe propozon që të lejoj këtë kosto plotësisht.

3.1.8 Renovimi i Njësive A3, A4, A5

Gjatë ndërprerjes vjetore të vitit 2015 dhe 2016, KEK-u ngjashëm planifikon që të kryej riparime kapitale dhe renovime në të gjitha tri njësitë operative të Kosovës A. Në paraqitjen e tyre në ZRRE, KEK-u ka vlerësuar se kostot totale vjetore për tri njësitë.. ZRRE e pranon arsyeshmërinë për t'i kryer këto punë vjetore, por se nuk sheh ndonjë arsyetim për ngritje në koston e njesisë. Prandaj, ZRRE propozon që të lejoj një kosto prej €2.5 milion për të tri njësitë në secilin vit 2015 dhe 2016 se kërkesa e KEK-ut.

3.1.9 Pompat e reja të kazanit me shpejtësi të ndryshueshme të furnizimit, Njësia A3, A4

KEK-u këshillon që pompat furnizuese që i shërbejnë kazanëve në Njesisë A3 dhe A4 kërkojnë zëvendësimin me pompa të shpejtësisë së ndryshueshme për furnizim.. Kostot e planifikuara kanë qenë me te larta, megjithatë, gjatë diskutimeve me KEK-un është e qartë

se këto pompa janë prokuruar më herët në një kostome te ulët, dhe ZRRE propozon që të lejoj këto kosto në vlerën e realizuar.

3.1.10 Vlerësimi i Përkohshëm i ZRRE-së për Capex për Kosovën A

Vlerësimi i përkohshëm i ZRRE-së për Capex për Kosovën A është dhënë në tabelën g poshtë.

Tabela g – Vlerësimi i Përkohshëm i Projekteve Kapitale i Kosovës A

| Vlerësimi i përkohshëm i ZRRE-së për capex për Kosovën A | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | Total |
|--|---------|---------|---------|---------|---------|---------|
| | € 000's | € 000's | € 000's | € 000's | € 000's | € 000's |
| Capex i kërkuar i KEK-ut | 40,417 | 22,860 | 19,530 | 12,750 | 10,000 | 105,557 |
| Capex i propozuar i ZRRE-së | 40,417 | 22,118 | 16,760 | 9,260 | 7,500 | 96,055 |
| Diferenca (€ 000's) | 0 | -0,742 | -2,770 | -3,490 | -2,500 | -9,502 |
| Diferenca % | -0% | -8% | -14% | -27% | -25% | -10% |

3.2 Opex i Propozuar i Kosovës A

3.2.1 Rialokimi i kostove të administratës qendrore

ZRRE i ka rialokuar kostot e administratës qendrore për Kosovën A në të njëjtën mënyrë siç janë përshkruar për Divizionin e Minierës në pjesën 3.2.1 më lartë.

3.2.2 Kostot e staf-it

Në kalkulimet e saja, KEK-u ka supozuar një rrite prej 5% në kostot e njësisë së punonjësve për njësinë e Kosovës A mbi koston e inflacionit. ZRRE nuk sheh ndonjë arsytim për këtë ngritje në kostot e stafit në terma real. Prandaj, propozon që të lejoj që kostot e pagave të qëndrojnë të qëndrueshme në nivelet e vitit 2012 për periudhën e kontrollit. Si rezultat, kostot e stafit për periudhën e rregullatore janë korrigjuar.

3.2.3 Energjia elektrike dhe shërbimet tjera komunale

KEK-u ka paraparë shpenzime prej diku €30 milion gjatë periudhës 2013-2016 për "Energjinë elektrike dhe shërbimet tjera komunale" për Kosovën A, i cili përbëhet prej: koston së derivateve (duke mos përfshirë koston e thëngjillit), koston e lubrifikantit dhe kemikalet tjera, dhe kostot e ngjashme të transmisionit të energjisë elektrike.

Kostoja e derivateve, e cila i referohet koston së derivateve të rënda të vajit arrihet si përbërës i kostove të njësisë së projektuar të derivatit të vajit dhe shumave të pritura të derivatit të vajit që do të shfrytëzohet. EIHP ka ekzaminuar supozimet prapa këtyre vlerave dhe konsideron se ato janë të arsyeshme. Prandaj, ZRRE ka propozuar që t'i lejoj këto shuma plotësisht.

3.2.4 Kostot e mirëmbajtjes

Kategoria e mirëmbajtjes përbëhet prej shërbimeve të riparimit dhe të shërbimit të mirëmbajtjes. Për periudhën e vështruar rregullatorë nuk janë paraparë shërbimet e riparimit. I licencuari ka paraparë vetëm shërbime të mirëmbajtjes me trendin në rritje të kostos së njësisë, e shprehur në MWh të energjisë elektrike të gjeneruar.

EIHP e ka korrigjuar shumën e kërkuar, duke supozuar koston e standardizuar prej €0.92/MWh të energjisë elektrike të gjeneruar, vlerë kjo e arritur gjatë vitit 2011. ZRRE e konsideron këtë korrigjim të përshtatshëm, dhe prandaj kostot e mirëmbajtjes janë të korrigjuara dhe janë më të ulta në shumën prej nga €3.35 milion.

3.2.5 Kostot e Materialeve dhe Furnizimeve

Kostot e materialeve dhe furnizimeve janë vlerësuar nga KEK-u në nivelin prej 4.85 milion për periudhën 2013-2016. EIHP beson se kostoja njësi duhet të jetë konstante në terma real, e shprehur si €/MWh. Duke marrë parasysh se kostoja për njësi ka pas variacion në mënyr substanciale në dy vitet e fundit, EIHP e ka përdor mesataren për vitet 2010-2011 e cila është €0.673 për MWh të energjisë elektrike të gjeneruar. Si pasojë, është bërë korrigjimi dhe është përcaktuar vlera €0.4 milion.

3.2.6 Shpenzimet tjera operative

Sipas “shpenzimeve tjera operative” për Kosovën A, KEK-u ka kosto totale të parashikuara prej €11.4 milion në periudhën 2013-2016. Kjo përbën rialokim të kostove të administratës qendrore, kostove të sigurisë, licencave dhe shpenzimeve “tjera”.

Sa i përket **alokimit të kostove të administratës qendrore**, këto janë korrigjuar dhe janë më të ulta, duke përcjell të njëjtën qasje si për të licencuarit dhe “shpenzimet tjera”.

Kostot e sigurisë janë kërkuar në nivel prej €0.4 milion/ në vit për tërë periudhën rregullatorë, dhe është e barabartë me vlerën e vlerësuar për vitin 2012.

Kostot e të licencuarit

KEK-u ka parashikuar një nivel të ndryshueshëm të koston për t’i mbuluar “licencat”. ZRRE propozon që të rishikoj qasjen e vet në përcaktimin e tarifave të licencave në fillim të vitit të ri, atëherë kur buxheti i ri vjetor të kalohet nga Kuvendi dhe do të caktoj një lejim adekuat në atë kohë.

Shpenzimet tjera janë korrigjuar dhe janë më të ulta duke shfrytëzuar vlerën mesatare për periudhën e vitit 2011-2012 d.m.th. €396,000 /në vit.

Në përgjithësi, shpenzimet tjera operative të korrigjuara janë më të ultë për €1.3 milion se sa shuma e kërkuar nga KEK-u në parashtresën e tij.

3.2.7 Vlerësimi i Përkohshëm i ZRRE-së të Propozimeve të Opex për Kosovën A të KEK-ut

Tabela më poshtë i përmbledh shpenzimet totale operative të propozuara nga KEK-u për Kosovën A për periudhën 2013 deri 2016, së bashku me vlerësimin e propozuar të ZRRE-së të atyre shpenzimeve të njëjta. Duhet vënë re se tabela poshtë ë përijashton koston e brendshme të thëngjillit e cila paguhet nga Kosova A për Divizionin e Minierës.

Tabela h – vlerësimi i përkohshëm i Opex i Kosovës A

| Vlerësimi i përkohshëm i ZRRE-së i opex i Kosovës A | 2013 € 000's | 2014 € 000's | 2015 € 000's | 2016 € 000's | Totali € 000's |
|---|-----------------|-----------------|-----------------|-----------------|-------------------|
| Opex i kërkuar i KEK-ut | 20,664 | 21,084 | 21,375 | 21,424 | 84,547 |
| Opex i propozuar i ZRRE-së | 19,272 | 18,985 | 18,783 | 18,561 | 75,602 |
| Diferenca (€ 000's) | -1,392 | -2,099 | -2,592 | -2,863 | -8,945 |
| Diferenca % | -7% | -10% | -12% | -13% | -11% |

3.3 Kosova B – Capex i propozuar

Projektet kapitale të planifikuara për Kosovën B gjatë periudhës janë të përshkruara në Aneksin A, së bashku me një vlerësim teknik të arsyetimit të KEK-ut për projektet.

Përveç projekteve të planifikuara për periudhën e ardhshme të kontrollit, 2013-2016, parashtresa e KEK-ut përmbante një numër projektesh për vitin 2012, të treguara në tabelën poshtë. Megjithatë, ashtu siç është përshkruar në pjesën 2.1 më lartë, nuk është e qartë kostot e propozuara për projektet e vitit 2012 nuk përbëjnë një element të kalkulimit të dyfishtë në lidhje me lejimin kapitale të SHTE6. Ashtu sikur me capex të minierës, ZRRE përkohësisht i ka lejuar këto projekte, por mban të drejtën që t'i refuzoj ato plotësisht apo pjesërisht, nëse KEK-u nuk e demonstroi në mënyrë adekuate që këto projekte nuk janë mbuluar në SHTE6.

Tabela i – Kosova B Projektet kapitale në vazhdim e sipër

| Projektet kapitale të propozuara të KEK-ut për Gjenerim Kosova B | 2012 €000s | 2013 €000s | 2014 €000s | 2015 €000s | 2016 €000s | Total €000s |
|--|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|----------------|
| Projektet e vazhduara nga viti 2012 | | | | | | |
| Renovimi kapital Njësia B1 | | | | | | |
| Ndërprerës qarku Njësitë B1 dhe B2 | | | | | | |

| | |
|--|---------------|
| Motor me shpejtësi të ndryshueshme për Njësitë B | |
| Rotorët për pompat e kazanëve për Njësitë B (4) | |
| Motorët elektrik për Njësitë B | |
| Punë e paparashikuar/ e paplanifikuara | |
| Totali 2012 projektet kapitale të vazhduara | 27,570 |

Përveç kësaj, *tabela j* më poshtë i tregon projektet kapitale për Kosovën B të planifikuara nga KEK-u nga Divizioni gjenerues i KEK-ut për periudhën e kontrollit të ri, 2013-2016:

Tabela j – Kosova B Projektet kapitale të propozuara 2013-2016

| Projektet për 2013-2016 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | Total |
|---|---------------|---------------|--------------|---------------|---------------|---------------|
| | €000s | €000s | €000s | €000s | €000s | €000s |
| TCB-2550 rrethoja 7 portat e rrethojës të ngritura lartë | | | | | | |
| Kamerat e vëzhgimit | | | | | | |
| Makinë e re e zjarr fikjes | | | | | | |
| Cilindra me presion të lartë, sistem i bluarjes & tjera | | | | | | |
| Turbinë e re me kornizë të jashtme me opresion të lartë Njësia B1 | | | | | | |
| Renovim kapital pesë vjeçar Njësia B1 | | | | | | |
| Renovim kapital pesë vjeçar Njësia B2 | | | | | | |
| Modernizim i sistemit për bluarjen e thëngjillit dhe transporti | | | | | | |
| Totali i projekteve kapitale të shpenzimeve 2013-2016 | | | | | | 56,072 |
| Totali i shpenzimeve kapitale (të gjitha vitet) | 27,570 | 15,072 | 4,000 | 22,000 | 15,000 | 83,642 |

3.3.1 TCB - 2550 rrethoja (duke i përfshirë 4 portat me rrethojë të ngritur lartë)

Sikur për Kosovën A, KEK-u gjithashtu ka propozuar që të ngritët rrethoja e cila është e nevojshme për të ndarë dhe për të mbrojtur pronën e paluajtshme të Termo centralit Kosova B nga divizionet fqinje të thëngjillit. KEK-u ka ofruar arsytetime të mjaftueshme për këtë kosto dhe ZRRE e konsideron këto kosto të arsyeshme dhe propozon të lejoj plotësisht.

3.3.2 Kamerat e vëzhgimit

KEK-u ka propozuar që të instalohen kamerat e sigurisë që kanë për synim të monitorojnë objektin e Termo centralit të Kosovës B që instalohen në intervale prej 60 metra në rrethojën e re të sigurisë. ZRRE e konsideron këtë të arsyeshme dhe propozon që të lejoj këtë kosto plotësisht

3.3.3 Makinë e re e zjarr fikjes për gjenerim

Sikur me Kosovën A, KEK-u ka për synim që të blej një makinë të re të zjarr fikjes për stacionin e Kosovës B, me shkallë prej 40 metra pasi që pajisjet ekzistuese nuk mund të arrijnë ë mjaft lartë. ZRRE e konsideron këtë të arsyeshme dhe propozon që të lejoj këtë kosto.

3.3.4 Hapja e cilindrave me presion të lartë dhe të tjera

Në versionin e fundit të shabllonëve të pranuar, ky artikull është ndarë në “Modernizimi i transmisionit te sistemit te mullinjve (16 mullinj)” dhe “KF, oxhaku, dhe tjera”. Duke marrë parasysh se nuk është ofruar kurrfarë përkthimi zyrtar, EIHP beson se artikulli i parë i referohet zëvendësimit të 16 mullinjve. 5 mullinj tashmë janë zëvendësuar dhe kjo kosto është shkaktuar. EIHP nuk ka gjetur mjaft dëshmi mbështetëse për zëvendësimin e 11 mullinjve shtesë. Pa ndonjë arsyetim shtesë për shpenzimet tjera, ZRRE ka propozuar që të lejoj vetëm kostot për të cilat janë ofruar dëshmi mbështetëse.

Artikulli i dytë, “KF, oxhaku, dhe tjera” i referohet renovimit të sistemeve të përbashkëta (kullave ftohëse, oxhakëve, trajtimit kimik të ujit), këto kosto duken të jenë të arsyeshme, dhe ZRRE ka propozuar që të lejoj këtë shumë plotësisht.

3.3.5 Kornizë e re e jashtme për turbinën me presion të lartë, Njësia B1

Korniza e turbinës me presion të lartë për Njësinë B1 është e qarë dhe operimi i saj në këto kushte konsiderohet i pasigurt. Turbina është turbinë Alstom dhe korniza duhet të dizajnohet dhe të ndërtohet nga ajo kompani. Ka kohë në interval prej 12 muajve. Vlerësimi i Alstom tashmë është pranuar dhe prandaj, ZRRE propozon që t’i lejoj këto kosto, por në vlerën e zvogëluar të vlerësimit prej €1 milion.

3.3.6 Renovimi kapital, Njësia B1

KEK-u propozon që të zbatoj riparimin kapital të vet pesë vjeçar të njësive B2 (2015) dhe B1 (2016) gjatë periudhës së ardhme kontrolluese. Punët do të përfshijnë renovimet kapitale të turbinës së avullit të njësisë, elektrogjeneratorin dhe kazanin. EIHP ka këshilluar që kjo t’i përshijë paisjet që nuk i konsideron si të nevojshme për t’u blerë nga një operator efikas (p.sh. dera e njësisë për B1 dhe B2). Prandaj ZRRE i ka zvogëluar ndihmën kapitale të KEK-ut për këta artikuj kapital për €2 milion për secilin renovim kapital.

3.3.7 Vlerësimi i përkohshëm i ZRRE-së i Capex për Kosovën B

Vlerësimi i përkohshëm i ZRRE-së për Capex për Kosovën B është dhënë në tabelën k më poshtë.

Tabela k – Vlerësimi i përkohshëm i Capex Kosova B

| Vlerësimi i përkohshëm i ZRRE-së i Capex për Kosovën B | 2012 € 000's | 2013 € 000's | 2014 € 000's | 2015 € 000's | 2016 € 000's | Total € 000's |
|--|-----------------|-----------------|-----------------|-----------------|-----------------|------------------|
| Capex i kërkuar i KEK-ut | 27,570 | 15,072 | 4,000 | 22,000 | 15,000 | 83,642 |
| Capex i propozuar i ZRRE-së | 17,343 | 11,572 | 2,500 | 13,000 | 13,000 | 57,415 |
| Diferenca (€ 000's) | -10,227 | -3,500 | -1,500 | -9,000 | -2,000 | -26,227 |
| Diferenca % | -537% | -23% | -38% | -41% | -13% | -31% |

3.4 Kosova B Opex i Propozuar

3.4.1 Rialokimi i kostove të administratës qendrore

ZRRE i ka rialokuar kostot e administratës qendrore për Kosovën B në të njëjtën mënyrë ashtu siç është përshkruar për Divizionin e Minierës në pjesën 3.2.1 më lartë.

3.4.2 Kostot e stafit

Sikur për Kosovën A dhe aktivitetet tjera të licencuara, KEK-u ka supozuar një rritje prej 5% në kostot e njësisë së punonjësve për stacionin e Kosovës A mbi koston e inflacionit. ZRRE nuk sheh ndonjë arsytim për këtë ngritje në kostot e stafit në terma real. Prandaj, propozon që të lejoj që kostot e pagave të qëndrojnë të qëndrueshme në nivelet e vitit 2012 për periudhën e kontrollit për Kosovën B.

3.4.3 Energjia elektrike dhe shërbimet tjera komunale

KEK-u ka paraparë shpenzime prej diku €26 milion gjatë periudhës 2013-2016 për “Energjinë elektrike dhe shërbimet tjera komunale” për Kosovën B, një njësi kostoje i cili përbëhet prej: koston së derivateve (duke mos përfshirë koston e thëngjillit), koston e lubrifikantit dhe kemikalet tjera, dhe kostot e ngjashme të transmisionit të energjisë elektrike.

Kostoja e derivateve, e cila i referohet koston së derivateve të rënda të vajit arrihet si përbërës i kostove të njësisë së projektuar të derivatit të vajit dhe shumave të pritura të derivatit të vajit që do të shfrytëzohet. EIHP ka ekzaminuar supozimet prapa këtyre vlerave dhe konsideron se ato janë të arsyeshme. Prandaj, ZRRE ka propozuar që t'i lejoj këto shuma plotësisht.

ZRRE e ka korrigjuar parashikimin e KEK-ut të kostove të transmisionit të energjisë elektrike në €0.9 milion , duke supozuar koston për njësi për transmetimin e energjisë prej €0.53/MWh konstante sipas nivelit të realizuar në 2012.

3.4.4 Kostot e mirëmbajtjes

Kjo kategori përbëhet prej shërbimeve të riparimit dhe shërbimeve të mirëmbajtjes. Për periudhën e vështruar rregullatorë nuk janë paraparë shërbimet e riparimit. I

licencuari ka paraparë vetëm shërbime të mirëmbajtjes me trendin në rënie të kostos së njësisë, e shprehur në MWh të energjisë elektrike të gjeneruar. ZRRE pajtohet me vlerësimin e EIHP se i ka gjetur vlerat e kërkuara të arsyeshme dhe nuk ka bërë ndonjë korigjim.

3.4.5 Shpenzimet tjera operative

Sipas “shpenzimeve tjera operative” për Kosovën B, KEK-u ka kosto totale të parashikuara prej €12.6 milion në periudhën 2013-2016. Kjo përbën rialokim të kostove të administratës qendrore , kostove të transportit, sigurisë, licencave dhe shpenzimeve “tjera”.

Sa i përket **alokimit të kostove të administratës qendrore** , këto janë korigjuar në rënie, duke përcjell të njëjtën qasje të shfrytëzuar për të licencuarit tjerë.

Kostot e shërbimit të transportit, të propozuara nga i licencuari, janë korigjuar dhe janë më të ulta duke u bazuar në nivelin e vitit 2011 gjatë viteve 2012-2016, viti i vetëm historik për të cilin kjo kosto është regjistruar.

Kostot e sigurisë janë kërkuar në nivel e njëjtë me vitin e kaluar për tërë periudhën rregullatorë.

Kostot e të licencuarit ZRRE propozon që të rishikoj qasjen e vet në përcaktimin e tarifave të licencavenë fillim të vitit të ri, atëherë kur buxheti i ri vjetor të kalohet nga Kuvendi dhe do të caktoj një lejim adekuat në atë kohë.

Shpenzimet tjera janë korigjuar dhe janë më të ulëta, duke shfrytëzuar vlerën mesatare për periudhën e vitit 2011-2012.

Në përgjithësi, *shpenzimet tjera operative* të korigjuara për Kosovën B janë më të ultë për €2.6 milion se sa shumata e kërkuar nga KEK-u në paraqitjen e tij.

3.4.6 Vlerësimi i Përkohshëm i ZRRE-së i propozimeve Opex të Kosovës B të KEK-ut

Tabela më poshtë i përmbledh shpenzimet totale operative të propozuara nga KEK-u për Kosovën A për periudhën 2013 deri 2016, së bashku me vlerësimin e propozuar të ZRRE-së të atyre shpenzimeve të njëjta. Duhet vënë re se tabela poshtë e përjashton koston e brendshme të transferit të thëngjillit.

Tabela I – Vlerësimi i përkohshëm i Opex Kosova B

| Vlerësimi i përkohshëm i ZRRE-së i Opex Kosova B | 2013 € 000's | 2014 € 000's | 2015 € 000's | 2016 € 000's | Total € 000's |
|--|-----------------|-----------------|-----------------|-----------------|------------------|
| Opex i kërkuar i KEK-ut | 17,385 | 17,668 | 17,976 | 18,242 | 71,272 |
| Opex i propozuar i ZRRE-së | 16,253 | 16,245 | 16,245 | 16,273 | 65,016 |
| Diferenca (€ 000's) | -1,131 | -1,423 | -1,731 | -1,969 | -6,256 |
| Diferenca % | -7% | -8% | -10% | -11% | -9% |

4 Parametrat tjerë rregullatorë

4.1 Faktorët e efikasitetit

Me Rregullin për përcaktimin e çmimit, ZRRE obligohet që të përcaktojë një faktor efikasiteti i cili do të vlejë për kostot operative dhe të mirëmbajtjes. Për tërë periudhën e TSHV-së, do të përcaktohet një faktor i vetëm dhe atë në nivel i cili pritet të pasqyrojë fitimet të cilat mund të priten gjatë kësaj periudhe nga një i licencuar efikas. Në përcaktimin e nivelit të efikasitetit, ZRRE ka marrë parasysh kostot e udhëheqjes së biznesit për divizionin e gjenerimit dhe minierave, krahas niveleve të produktivitetit në kompanitë e krahasueshme ndërkombëtare. Gjithashtu, ka marrë parasysh nivelet e faktorit të efikasitetit të cilët janë aplikuar me sukses në regjimet rregullative gjetiu nëpër botë.

ZRRE konstaton se ka hapësirë për fitime domethënëse në efikasitet në veprimtarinë e divizionit e Gjenerimit dhe Minierave, posaçërisht pasi kjo do të jetë herë e parë që është aplikuar një faktor efikasiteti në kompani ndërsa përvoja tregon që kompanitë janë në gjendje të demonstrojnë përfitime në efikasitet në këtë fazë të hershme të rregullimit të stimulimit. ZRRE konsideron se vlera prej 4% në vit është një faktor i qëlluar në periudhën e TSHV-së, që përfaqëson një stimulim sfidues për divizionin e Gjenerimit dhe Minierave që të ul koston e vet dhe të përfitojë në rast të performancës më të mirë nga ajo e pritura, duke krijuar kështu përfitime edhe për konsumatorë përmes uljes së presionit në tarifa.

4.2 WACC

ZRRE ka supozuar Mesataren e Ponderuar të Kostos së Kapitalit (WACC) për Divizionin e Minierave duke u bazuar në vlerësimet paraprake të kërkeses për kthim të ekuitetit, kostove aktuale të financimit të borxhit dhe nivelit aktual të gearing-ut (duke përfshirë restriksionet e paraqitura në lidhje me gearing-un në diskutimet e mëhershme të ZRRE-së lidhur me WACC)

Fillimisht ZRRE ka supozuar se të gjitha kompanitë e rregulluara kërkojnë kthim komercial në ekuitet. Më tutje ZRRE ka kërkuar nga Qeveria udhëzime lidhur me nivelin e kthimit në

ekuitet që qeveria do të kërkonte si pronare e vetme e kompanive publike. Qeveria është shprehur se do të konsiderojnë kthim më të ulët në ekuitet nga operatorët në pronësi publike krahasuar me kthimin që do të mund të kërkohej nga një operator privat. Vlerësimi fillestar i ZRRE-së është se niveli i kthimit në ekuitet prej 8.0% (pas taksës) do të ishte i duhur për kompani në pronësi publike. ZRRE ka përdorur këtë kthim në ekuitet për të vlerësuar WACC-un e divizionit të Gjenerimit.

WACC-u rezultues për Divizionin e Gjenerimit është 6.89% (real, para tatimit)

5 MAR i përkohshëm 2013-2016

Pas këtij vlerësimi të propozimeve të kostos kapitale dhe operative të KEK-ut, vlerësimet e përkohshme të përshkruara më lartë, dhe parametrat e tij të propozuar rregullatorë, ZRRE i ka kalkuluar MAR-të për aktivitetet e licencuara të KEK-ut në përputhje me Rregullin e Çmimit të Gjenerimit. Këto janë dhënë në tabelën si në vijim.

Tabela m – Vlerësimi i përkohshëm i MAR për Gjeneratorët e rregulluar të KEK-ut

| Vlerësimi i përkohshëm i MAR për divizionet e gjenerimit të rregulluar të KEK-ut | 2013 € 000's | 2014 € 000's | 2015 € 000's | 2016 € 000's | Gjithsej € 000's |
|--|-----------------|-----------------|-----------------|-----------------|---------------------|
| Kosova A dhe B | 155,227 | 156,477 | 158,485 | 158,866 | 629,055 |